

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7048  
E mërkurë, 15 nëntor 2023  
Çmimi 0.50 €

## Gërvalla kërkon reagim më të qartë të BE-së ndaj aktit të agresionit të Serbisë



TAKIM ME MINISTRAT E JASHTËM TË BE-SË

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# QYTETARËT TË ZHGËNJYER ME KURTIN PËR 'PRANIMIN E ASOCIACIONIT'

FAQE 4-5



Qytetarët e Kosovës janë në terr informativ sa i përket draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, të cilin ndërkombehtarët në mënyrë ultimative po kërkojnë të formohet. Qytetarët e

intervistuar kanë shprehur zhgënjim në kryeministrin Kurti në lidhje me pranimin e këtij drafti. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se të gjithë aktorët politikë dhe

jopolitikë që janë pjesë e këtij terri informativ në mënyrë flagrante po i shkelin të drejtat e njeriut dhe se do t'i bartin pasojat elektorale, por edhe ligjore në një kohë të përshtatshme

## AKTUALE




**VUÇIQI PAS TAKIMIT ME LAÇAKUN: SERBIA, E GATSHME PËR DIALOG, DO TË RESPEKTOJË GJITHÇKA QË KA NËNSHKRUAR** F. 2

**25 TË RINJ NGA DIASPORA PËRFORCOJNË LIDHJET ME KOSOVËN PËRMES DIPLOMACISË QYTETARE** F. 6

**PAS BETEJËS GJYQËSORE, RIKTHEHEN NË PUNË 19 ZYRTARËT KOMUNALË TË GJILANIT** F. 6

## EKONOMI



**8.1 MILIONË EURO TATIMI SHITESË NGA HETIMET TATIMORE** F. 8

**PARALAJMËROHET PROTESTË NDAJ KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR MOSRRITJEN E PAGAVE PËR PUNËTORËT TEKNIKË** F. 8

## SPORT



**SONTE PEJA DHE TREPÇA ZHVILLOJNË NDESHJET NË FIBA EUROPE CUP** F. 10

**QEVERIA DUHET T'I NJOHË ORGANIZATAT E SHOOËRISË CIVILE SI PARTNERE NË PROCESIN E NEGOCIATAVE NË BE**



**KOSOVA KËRKON PRONËN NË MAL TË ZI QË I ËSHTË MARRË NË SERBI** FAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Vuçiçi pas takimit me Lajçakun: Serbia, e gatshme për dialog, do të respektojë gjithçka që ka nënshkruar

**BEOGRAD, 14 NËNTOR** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, gjatë takimit të martën në Beograd me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, tha se Serbia është gjithmonë e gatshme për dialog dhe të respektojë gjithçka që ka nënshkruar dhe që është pajtuar.

Në një njoftim për medie të lëshuar nga Presidenca e Serbisë, thuhet se Vuçiçi ka ripërsëritur se Serbia dëshiron shtensionim, paqe dhe stabilitet. Po në njoftim u tha se Vuçiçi insistoi në themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, por në takim janë diskutuar edhe

tema të tjera të rëndësishme të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Ndërkaq emisari evropian Lajçak tha se në takim me zyrtarët serbë bisedoi për zbatimin e marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit të raporteve Kosovë - Serbi.

"Pas vizitës sime në Kosovë, po ashtu udhëtova për në Beograd për ta përgatitur takimin e kësaj jave të kryenegociatorëve. Me presidentin [e Serbisë, Aleksandar Vuçiçi] dhe me [drejtorin e Zyrës për Kosovën në Qeverinë Serbe] Petar Petkoviç, diskutova për mënyrën përpara në dialog për hapat e nevojshëm për zbatimin e marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit", ka



shkruar Lajçak në "X". Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë Serbe, Petar Petkoviç, tha pas takimit se ftesa e Lajçakut për ta vazhduar dialogun për normalizimin e raporteve më 16

nëntor në Bruksel është pranuar. "Ne do të diskutojmë për tekstin e draft-statutit të Asociacionit. Pala jonë do të shkojë me një ekip ekspertësh", ka theksuar Petkoviç. Më 16 nëntor kryenegociatori i

Kosovës, Besnik Bislimi, dhe ai i Serbisë, Petar Petkoviç, do të takohen në Bruksel.

Vizita e Lajçakut në Serbi vjen pasi ai më 7 nëntor vizitoi Kosovën, ku diskutoi me përfaqësuesit e qeverisë dhe të opozitës për draft-statutin e ri për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Propozimi i ri "për një model modern evropian" për draft-statutin e Asociacionit u është paraqitur Kosovës dhe Serbisë nga anëtarët e "Pesëshes së Madhe" gjatë vizitës së tyre në këto dy shtete më 21 tetor. Delegacioni përbëhej nga përfaqësues të BE-së, të Shteteve të Bashkuara, të Gjermanisë, të Francës dhe të Italisë.

## BE-ja has në vështirësi për ta furnizuar Ukrainën me municionin e premtuar

**BRUKSEL, 14 NËNTOR** - Vendet e Bashkimit Evropian e kanë pranuar të martën se mund të dështojnë ta furnizojnë Ukrainën me municionin që ia kishin premtuar për ta luftuar pushtimin rus dhe për ta çliruar territorin e uzurpuar.

Në fillim të këtij viti liderët e BE-së u zotuan se do t'ia dërgonin frontit të Ukrainës një milion copë municion deri në pranverë të vitit 2024. Kjo do të nënkuptonte rritje të jashtëzakonshme të prodhimit. Por, blloku i përbërë nga 27 vende, thotë tani se e ka të vështirë ta bëjë një gjë të tillë. "Shifra një milion nuk do të arrihet, duhet ta hamendësojmë këtë", tha ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, Boris



Pistrius, para një takimi të ministrave të Mbrojtjes dhe të Jashtëm të BE-së në Bruksel. Ministri i Mbrojtjes i Estonisë, Hanno Pevkur, tha se është jetike

rritja e furnizimit me municion. "Shikojeni Rusinë. Po prodhon sot më shumë se kurrë më parë. Po merr predha nga Koreja e Veriut. Evropa nuk mund të thotë... Rusia

dhe Koreja e Veriut mund ta bëjnë e ne nuk mundemi", tha ai.

Rreth 300 000 copë municion i janë dërguar asaj nga depot ekzistuese të BE-së deri më tani.

Ministri i Mbrojtjes i Letonisë, Andris Spruds, nguli këmbë se caku fillestar nuk duhet të merret si diçka e saktë. "Epo, natyrisht, një milion copë janë simbolike. Mendoj se të rëndësishme janë aspirata dhe ambicia", tha ai.

Në fushëbetje, megjithatë, prania e municionit është gjëja e vetme që ka rëndësi.

Në luftën e Ukrainës me Rusinë, predhat e artilerisë 155mm luajnë rol vendimtar. Harxhimi i 6 000 deri në 7 000 predhave në ditë tregon për rëndësinë strategjike të tyre.

Nëse i merr një milion copa municion të tillë, Ukraina do ta siguronte stabilitetin për të paktën gjashtë muaj, sipas ekspertëve.

Komisionari i BE-së, Thierry Breton, nguli këmbë se industria e prodhimit mund ta arrijë cakun e një milioni copash municion. "Por, tani u takon shteteve anëtare t'i bëjnë porositë", theksoi ai.

Megjithatë, shtetet anëtare i fajësuam prodhuesit. "Të gjithë ne kemi nënshkruar kontratat. Ne e kemi bërë prokurimin e përbashkët. Prandaj, industria duhet ta kryejë punën. I duhet ta përsheptojë punën për të prodhuar më shumë", tha ministria e Mbrojtjes e Holandës, Kajsa Ollongren.

## Franca regjistron mbi 1 500 incidente antisemitike që nga 7 tetori

**PARIS, 14 NËNTOR** - Më shumë se 1 500 veprime dhe deklarata antisemitike janë regjistruar në Francë që nga shpërthimi i luftës së Izraelit me Hamasin - grup palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian - tha të martën ministri i Brendshëm, Gerald Darmanin. Ndërsa ka nisur lufta në Rripin e Gazës, janë rritur tensionet në Francë, shtet në të cilin jetojnë komunitetet e mëdha hebreje dhe myslimane. "Ka pasur 1 518 veprime apo deklarata antisemitike", tha Darmanin në një intervistë për transmetuesin "Europe 1".

Kjo shënon rritje për më shumë se

trefish në krahasim me të gjithë vitin 2022 kur u regjistruan 436 veprime apo deklarata antisemitike. "Këto janë kryesisht etiketime dhe fyerje, por ka edhe sulme dhe lëndime", tha Darmanin.

Këto veprime rezultuan me 571 arrestime, tha ministri për AFP.

Në fund të tetorit prokurorët e Parisit hapën hetim për një incident pasi dhjetëra Yje të Davidit u shfaqën në ndërtesat në qytet dhe në periferi.

Franca ka akuzuar Rusinë për ndërhyrje në punët e saj duke shpërndarë foto në internet të grafitëve antisemitike.

Darmanin tha se ka pasur gjithashtu incidente



antimyslimane, "por ato nuk janë në shkallën e asaj që ne po shohim për sa i përket antisemitizmit". Ai tha se disa xhami kishin marrë kërcënime për dhunë.

Ministria e Drejtësisë tha për AFP të hënën se janë hapur 330 hetime për akte antisemitike dhe justifikimet e terrorizimit, që nga 7 tetori.

Të dielën më shumë se 180 000 njerëz marshuan kundër antisemitizmit në Francë.

Marshimi u zhvillua një ditë pasi mijëra njerëz demonstruan në Paris nën thirrjen "Stop masakrës në Gaza".

Më 7 tetor grupi ekstremist palestinez Hamas filloi një sulm në Izrael, duke vrarë rreth 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe duke marrë peng rreth 240 të tjerë, sipas zyrtarëve izraelitë.

Izraeli është kundërpërgjigjur me një bombardim të Rripit të Gazës dhe një pushtim tokësor, duke vrarë më shumë se 11 100 njerëz, shumë prej tyre fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazën e drejtuar nga Hamasi.

# Qeveria duhet t'i njohë organizatat e shoqërisë civile si partnere në procesin e negociatave në BE



**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Lëvizja FOL ka publikuar raportin "Si mund ta përmirësojë Kosova konsultimin dhe angazhimin e palëve të interesuara në procesin e negociatave për anëtarësim në BE?", raport i cili thellohet në përvojat e vendeve të rajonit në lidhje me rolin e shoqërisë civile, sektorin privat/odat ekonomike, akademinë, dhe palëve të tjera të interesuara në proceset e negociatave për anëtarësim në BE. Raporti vë në qendër të vëmendjes rastin e Sllovenisë, Kroacisë, Bullgarisë dhe

Rumanisë, vende që iu nënshtruan integritetit gjatë një periudhe 10-vjeçare dhe, gjithashtu, shqyrton kontributet e OSHC-ve në politikëbërje pas anëtarësimit të vendeve të tyre në BE. Burbuqe Kastrati nga Lëvizja FOL, e cila ka paraqitur gjetjet e këtij raporti, ka folur për procesin e deritanishëm të anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian (BE), duke filluar prej paraqitjes së kërkesës për anëtarësim në dhjetor të vitit 2021, shtatë vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Kosovës dhe BE-së në vitin 2015.

Kastrati ka shpjeguar rastet e vendeve të rajonit të Ballkanit, tashmë anëtarë të Bashkimit Evropian, konkretisht rastin e Sllovenisë. Sipas saj, një nga faktorët që dha kontribut të rëndësishëm në suksesin e Sllovenisë në procesin e integritetit evropian ishte sektori i gjallë i shoqërisë civile, i nxitur nga një kulturë e bashkëpunimit me institucionet publike. Gjithashtu, ajo ka thënë se Komisioni Evropian nënvizoi rolin kryesor të OJQ-ve, që veprojnë si agjentë të shoqërisë civile, në informimin dhe përmirësimin e të kuptuarit të institucioneve, politikave dhe vlerave të BE-së në mesin e

popullatës së përgjithshme në Slloveni. Gjatë procesit të anëtarësimit, Zyra e Komunikimit e Qeverisë Sllovene bashkëpunoi gjerësisht me OJQ të shumta për të shpërndarë informacione rreth institucioneve evropiane. Kastrati, gjithashtu, ka folur edhe procesin e pranimit të Bullgarisë dhe Rumanisë në vitin 2020, e cila mori një qasje nga lart-poshtë. "Qeveritë negociuan me BE-në, duke miratuar legjislacionin përmes parlamentit përmes pazareve shpesh të ndërlikuara për të akomoduar interesat e ndryshme politike. Ky manovrim legjislativ lejoi pak

hapësirë për liri veprimi politik. Shoqëria civile luajti një rol të konsiderueshëm, të profesionalizuar, të financuar nga burime perëndimore dhe të integruara në rrjetet transnacionale", ka thënë Kastrati.


Në fund Kastrati ka shpjeguar edhe rastin e Kosovës, ku tha se përfshirja e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në punën e strukturave të stabilizim-asociimit ka qenë e kufizuar dhe joefektive. "Shpesh Qeveria e Kosovës tenton t'i organizojë mbledhjet e strukturave të stabilizim-asociimit pa konsultime paraprake me shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara për materialet e takimeve. Kur organizohen takime konsultimi me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë, shpesh ato bëhen afër datës së takimeve të strukturave të stabilizimit asociimit dhe lënë pak hapësirë për ndryshime në agjendë. Veçanërisht shqetësuese është mungesa e përfshirjes së aktorëve të tjerë, përveç organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht sektorit privat", ka thënë Kastrati.

Ajo ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet t'i njohë organizatat e shoqërisë civile si partnere aktive në proceset vendimmarrëse në kuadër të Strukturave të Stabilizim Asociimit. "Kjo kërkon jo vetëm konsultim, por edhe përfshirje të vërtetë, duke përkthyer kontributin e shoqërisë civile në rezultate të prekshme të politikave", ka thënë Kastrati. Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Mbretërisë së Holandës përmes Ambasadës së Holandës në Kosovë.

## Rekomandimet e FOL-it për qeverinë

Raporti i publikuar i Lëvizjes FOL në fund ofron edhe disa rekomandime për qeverinë, të cilat janë: 1. Qeveria e Kosovës duhet të përgatisë një raport vlerësimi për përfshirjen e shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara në punën e strukturave të stabilizim-asociimit, në përputhje me Rregulloren QRK-Nr. 13/2016. 2. Prioritizimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik që komunikojnë përfitimet, sfidat dhe implikimet e integritetit evropian, duke larguar keqkuptimet dhe duke nxitur mbështetjen. Kjo është një fushë me të cilën shoqëria civile dhe qeveria e Kosovës kanë bashkëpunuar në mënyrë efektive në të kaluarën. 3. Qeveria duhet të rrisë konsultimet me sektorin privat në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe të njohë rolin integral të sektorit privat, duke pasur parasysh fokusin ekonomik të

Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Angazhimi i Odave të Ekonomisë dhe Tregtisë, së bashku me shoqatat specifike të sektorëve, në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes në lidhje me integritimin ekonomik. 4. Krijimi i praktikave transparente në lidhje me ndarjen e materialeve dhe agjendave të takimeve me organizatat e shoqërisë civile dhe palët e interesuara përpara takimeve zyrtare. 5. Përafrimi i Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 me objektivat e anëtarësimit në BE. 6. Pranimi se procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) është dinamik dhe mund të kërkojë ndryshime në strategji. 7. Krijimi i një platforme të bazuar në ueb, e dedikuar për të ndjekur progresin e plotë të nismave të BE-së me implikime të mundshme biznesi.



## Ambasadori i Kosovës në Francë ia dorëzon letrat kredenciale presidentit Macron

Prishtinë, 14 nëntor - Ambasadori i Kosovës në Francë, Mehdi Halimi, i ka dorëzuar letrat kredenciale presidentit francez Emmanuel

Macron. Ceremonia e dorëzimit të letrave kredenciale u bë në Pallatin presidencial Elysee. Momentin e dorëzimit të letrave

kredenciale ambasadori Halimi e ndau përmes platformës "X". Ai u shpreh se ndihet i nderuar që ka dorëzuar letrat kredenciale te presidenti Macron.



# Kosova kërkon pronën në Mal të Zi që i është marrë në Serbi

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) kërkon nga Ministria e Financave e Malit të Zi që ta ndalojë ndryshimin e pronësisë së patundshmërive të ish-ndërmarrjes shoqërore "PIK Kosova-Eksport - Industria e Mishit" nga Fushë-Kosova, iu konfirmua "Radios Evropa e Lirë". Pronat e saj ndodhen në Podgoricë, Tivar dhe Budvë.

Duke qenë se kjo agjenci, në përputhje me ligjin, menaxhon të gjitha ish-ndërmarrjet shoqërore të Kosovës, ajo pretendon se është pronarja e vetme e atyre pronave. Sipas saj, pas vitit 1999 këto prona janë përvetësuar ilegalisht nga kompania "Klanica" në Kraljevë, e cila më pas i ka shitur.

Ajo kërkoi dy herë nga Administrata për Pronë Shtetërore dhe Kadastrë e Malit të Zi që ta zhvlerësojë kontratën për shitjen e tyre, të cilën "Klanica" e ka lidhur në Serbi. Pasi administrata refuzoi, rasti përfundoi në Ministrinë e Financave të Malit të Zi, e cila është eprorë e Administratës. "Kemi paraqitur ankesë te një autoritet tjetër kompetent, Ministria e Financave, kundër vendimit të Drejtorisë së Kadastrës së Podgoricës, të datës 24 janar 2023, lidhur me ndryshimin e pronësisë së patundshmërive të PIK Kosovës në Mal të Zi", thanë për "REL"-in nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Administrata për Pronë Shtetërore dhe Kadastrë e Malit të Zi, e udhëhequr nga Koço Gjurihiq, përkundër disa premtimeve me shkrim gjatë dy javëve të komunikimit me REL-in, nuk iu

përgjigj pyetjeve në lidhje me kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. As Ministria e Financave e Malit të Zi.

## Vlera e pronave të PIK Kosovës

Bëhet fjalë për gati 1 000 metra katrorë hapësira biznesi në lokacione prestigjioze. Në qendër të Podgoricës janë shtatë të tilla me një sipërfaqe totale prej 700 metrash katrorë, prej të cilave 500 janë në katet përdhës të objekteve të banimit dhe 200 në bodrumet e tyre. Në qendër të Budvës është një hapësirë prej 60 metrash katrorë, ndërsa në Tivar prej 137 metrash katrorë, plus 47 metra katrorë bodrum.

## Çfarë ndodhi me patundshmëritë nga viti 1999?

Që nga nëntori i vitit 1999 patundshmëritë në Mal të Zi u menaxhuan nga kompania "Klanica" nga Kraljeva përmes kompanisë me të njëjtin emër në Mal të Zi, të themeluar po atë muaj, me seli në Podgoricë. Tre vjet më vonë, në gusht të vitit 2002, u themelua një kompani tjetër "Klanica Kraljevo" si pjesë e një kompanie të huaj me seli në Tivar, gjegjësisht në vendbanimin Sutomore, zbuloi "Radio Evropa e Lirë" përmes një kërkimi në Regjistrin Tregtar.

Kur kompania mëmë "Klanica Kraljevo" në Serbi falimentoi në mes

të vitit 2019, pronat në Mal të Zi u shitën përmes procedurave të falimentimit.

Ankandi publik u mbajt në Beograd më 8 shkurt 2022, sipas dokumentacionit të Agjencisë për Licencimin e Administratorëve të Falimentimit të Serbisë, në të cilin "REL"-i pati qasje.

Vlera e parashikuar e pasurisë së paluajtshme ishte rreth 620 000 euro dhe ajo iu shit për pak më pak se 240 000 euro shtetases së Bosnjës, Angjella Sekullovij, nga Sutomorja. Ajo bëri ofertën më të lartë në ankand në mesin e tre pjesëmarrësve nga Mali i Zi. Edhe pse oferta e Sekullovijit ishte vetëm 38 për qind e çmimit të kërkuar, shihta u miratua nga Bordi i Kreditorëve.

Në atë periudhë çmimi mesatar i hapësirës për zyra në qendër të Podgoricës ishte rreth 2 000 euro për metër katror, i thanë "REL"-it agjentë për shitjen e patundshmërive.

Kontrata e shitblerjes u bë më 22 shkurt 2022 dhe u vërtetua dhjetë ditë më vonë, më 4 mars (UOP-I 359-2022) nga noteri Zoran Jovanoviq nga Kraljeva. "Duke qenë se objekt i shitjes ishte debitori i falimentuar si person juridik, me pagesën e çmimit blerësi fitoi të drejtën e pronësisë 100 %... që përfshin të gjithë pasurinë e debitorit të falimentuar", thuhet në raportin e administratorit të falimentimit, Petar Vulloviq, nga Kraljeva, të cilin e pa "REL"-i.

## Rrëfim tjetër në Serbi

Për Serbinë kompania PIK Kosova nuk ekziston, sepse është fshirë nga regjistri gjyqësor më 31 dhjetor

1989, shkruhet në dokumentacionin e Vulloviqit.

Më tej thuhet se në vitin 2001 PIK Kosova i ka "shitur ilegalisht" patundshmëritë në Mal të Zi te kompania "Nacional AD" nga Danillovgradi. Ajo kompania ka shitur lokalit në Budvë gruas së drejtorit të "Nacional", Llella Radiçeviq, e ajo Zhelko Peroviqit. Lokalet e tjera afariste në Mal të Zi janë shitur Obren Simoviqit, sipas dokumentacionit të Vulloviqit, të datës 25 maj 2022, i cili ishte përgatitur për Agjencinë për Licencimin e Administratorëve të Falimentimit të Serbisë. Kjo agjenci është organi kompetent i Serbisë që kryen "detyrat profesionale me të cilat rregullohet falimentimi".

Për të gjitha objektet në Mal të Zi po zhvillohen procedura gjyqësore për kthimin e pronës së paluajtshme në posedim të kompanisë "Klanica Kraljevo", thuhet në të njëjtin dokument.

Aty nuk specifikohet se në cilat gjykata po zhvillohen këto procedura.

"REL"-i kontaktoi me Vulloviqin, i cili tha se "për të gjitha informatat duhet kontaktuar Agjencinë për Licencimin e Administratorëve të Falimentimit të Serbisë".

## Kontest në kadastrën e Malit të Zi?

Agjencia Kosovare e Privatizimit i tha "Radios Evropa e Lirë" se në Gjykatën në Kraljevë ka një procedurë kontestuese për shkak të përvetësimit të paligjshëm të pronës së një kompanie kosovare nga viti 1999 nga "Klanica Kraljevo".

Ajo paralajmëroi se procedurë e ngjashme do të nisë edhe para gjykatave në Mal të Zi. Kjo do të jetë e mundur vetëm kur të marrë përgjigje nga Ministria e Financave, tek e cila është ankuar për ndryshimin e pronësisë së patundshmërisë. Ankesa, siç thuhet, u miratua nga Drejtoria e Kadastrës e Podgoricës në fillim të vitit.

Drejtoria e Kadastrës e Podgoricës konfirmoi për "REL"-in se PIK Kosova nuk është e regjistruar si pronare e patundshmërive në Podgoricë.

Pas qasjes në kadastrën e patundshmërive në Mal të Zi, "REL"-i gjeti se të gjitha pronat janë ende në pronësi të kompanisë "Klanica" nga Kraljeva, ndërsa Zhelko Peroviq figuron si pronar i lokaleve në Budvë.

"REL"-i nuk arriti ta kontaktojë Angjella Sekullovijin, e cila, sipas dokumenteve të Agjencisë për Licencimin e Administratorëve të Falimentimit të Serbisë, ka blerë pronën e paluajtshme të kompanisë "Klanica Kraljevo" në Mal të Zi.

Sekullovij është e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Malit të Zi si drejtoreshë e "Klanica Kraljevës" me seli në Sutomore, e cila është pjesë e kompanisë me të njëjtin emër në Kraljevë - gjithashtu në pronësi të saj. Sipas të dhënave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të cilat i janë dhënë më herët REL-it, Kosova ka mbi 30 objekte pronësore në Mal të Zi, pronari i të cilave është ndërruar ilegalisht. Sipas burimit të njëjtë, Kosova ka 163 objekte pronësore, përkatësisht ndërmarrje shoqërore në vendet e ish-Jugosllavisë.



# Qytetarët e zhgënjyer me Kurtin për 'pranimin e Asociacionit'

Qytetarët e Kosovës janë në terr informativ sa i përket draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, të cilin ndërkombëtarët në mënyrë ultimative po kërkojnë të formohet. Qytetarët e intervistuar kanë shprehur zhgënjim në kryeministrin Kurti në lidhje me pranimin e këtij drafti. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se të gjithë aktorët politikë dhe jopolitikë që janë pjesë e këtij terri informativ në mënyrë flagrante po i shkelin të drejtat e njeriut dhe se do t'i bartin pasojat elektorale, por edhe ligjore në një kohë të përshtatshme

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Qytetarët e intervistuar nga "Ekonomia Online" kanë shprehur zhgënjim ndaj kryeministrit Albin Kurti në lidhje me pranimin draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tyre, shefi i ekzekutivit nuk e ka mbajtur fjalën për këtë çështje dhe se ka gënjyer kur ka thënë se nuk do ta pranojë. Murat Gerbeshi ka thënë se kryeministri Kurti nuk i ka mbajtur kurrë fjalët dhe se serbët

kanë më shumë të drejta sesa shqiptarët. "Kurti kurrë fjalët nuk i ka mbajtur dhe ka për t'i ndërruar sa të jetë gjallë. Serbët nga fillimi kanë më shumë të drejta se ne. Pse mos t'i paguajnë rrymën, tatimin dhe ujin. A nuk janë këto të drejta shumë?", pyeti ai. Ndërsa Enver Latifi e ka akuzuar Kurtin se po e mban të fshehur draftin e Asociacionit. "I ka ndërruar fjalët. Sa ka mundur ka gënjyer e po vazhdon të gënjëjë.

Gjithashtu, po e fsheh draftin dhe nuk po e tregon. Nuk po e di kurrkush asgjë", është shprehur ai, duke shtuar se "serbëve po u jep më shumë të drejta sesa neve. E kanë bordin e vet, e kanë kryetarin e vet, e kanë flamurin e vet, i kanë të gjitha", ka thënë Latifi.

Ndërsa Fatmir Bahriu ka besim të plotë në kryeministrin Kurti në lidhje me Asociacionin. "E ka mirë e do të bëhet mirë me siguri. Serbët pa fituar diçka nuk bën, por jo çka kërkojnë ata duhet me pas kujdes. Kurti është i kujdesshëm për këto punë dhe do t'i kryejë", është shprehur Bahriu.

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se bisedimet me Serbinë kanë hyrë në fazën e një transparence të munguar nga kryeministri Albin Kurti dhe vartësit e tij. Sipas KMDLNj-së, kryeministri Albin Kurti para deputetëve dhe qytetarëve, me një retorikë manipulative, vetëm sa e bën më të errët dhe më të panjohur dokumentin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me

Shumicë Serbe që po qarkullon në opinion. KMDLNj-ja ka theksuar se është sa befasuese aq dhe e papranueshme që edhe opozita është bërë kontribuuese e terri informativ pas takimit që kishte me Lajçakun në Prishtinë.

"Në emër të ruajtjes së konfidencialitetit që të mos dëmtohet procesi, politikanët vendorë (një numër i vogël i tyre) u shesin megjull qytetarëve të Kosovës duke i lënë në terr informativ dhe duke ngritur spekulime të ndryshme (në mungesë të informatave janë të arsyeshme) sidomos për Asociacionin e Komunave Serbe që në mënyrë ultimative po kërkojnë ndërkombëtarët të formohet. Në veçanti ka zgjuar kureshtje propozimi i pesëshes ndërkombëtare që i la kryeministrit të Kosovës mbi tavolinë pa zbuluar fare përmbajtjen apo duke bërë përpjekje ta mbështjellë me një mbështjellës kushtetues e që as për së afërmi i plotëson nevojat e qytetarëve për t'u informuar për këto zhvillime. KMDLNj e përkujton opinionin se të gjithë akterët politikë dhe jopolitikë që

janë pjesë e këtij terri informativ në mënyrë flagrante po i shkelin të drejtat e njeriut dhe se do t'i bartin pasojat elektorale por edhe ligjore në një kohë të përshtatshme", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Burim Ramadani, analist i sigurisë, ka publikuar draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që është propozuar nga pesë emisarë të BE-së dhe të ShBA-së. Ky dokument i jep mundësi Serbisë të funksionojë brenda Kosovës.

Miroslav Lajçak udhëhoqi një grup emisarësh perëndimorë në një vizitë në Prishtinë dhe Beograd më 21 tetor, duke i paraqitur Kosovës dhe Serbisë një draft-statut për Asociacionin. Megjithatë, përmbajtja e këtij statuti nuk është bërë publike deri më tani.

Kryeministri Kurti ka shprehur gatishmërinë e tij për ta pranuar dhe nënshkruar draft-statutin për krijimin e Asociacionit, ndërsa presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka përsëritur qëndrimin e tij se nuk do të pranojë asnjë dokument që përfshin njohjen de facto të Kosovës.

## Gërvalla kërkon reagim më të qartë të BE-së ndaj aktit të agresionit të Serbisë

Bruksel, 14 nëntor - Me ftesë të përfaqësuesit të lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, mori pjesë në takimimin e përbashkët me ministrat e jashtëm të

Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor. Në fjalën e saj, ministrja Gërvalla theksoi nevojën e reagimit dhe qëndrimit më të qartë të Bashkimit Evropian ndaj aktit të agresionit të Serbisë dhe dënimit e sulmit të 24 shtatorit kundër Kosovës. Në prag të këtij takimi,

ministrja Gërvalla takoi grupin "Miqte e Ballkanit Perëndimor", të cilin e përbëjnë shtetet si Austria, Kroacia, Çekia, Italia, Greqia, Sllovenia dhe Sllovakia.

Në këtë takim ministrja Gërvalla theksoi nevojën për një bashkëpunim më të fortë dhe ndihmë konkrete për

rajonin në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Ministrja Gërvalla paraprakisht pati takim edhe me ministrin e Jashtëm të Lituaniës dhe të Letonisë, me ç'rast diskutuan për situatën e sigurisë, të ardhmen evropiane të Kosovës dhe marrëdhëniet bilaterale në mes vendeve tona.



## Sveçla dhe Malaj takim njoftues, diskutojnë edhe për bashkëpunimin në të ardhmen

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur të martën në takim njoftues ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Petrit Malaj. Fillimisht ministri Sveçla e uroi Malajn për emërimin e tij ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë.

Në këtë takim u diskutua për marrëdhëniet e mira ndërmjet dy vendeve që do të vazhdojnë edhe më tutje, për zbatueshmërinë e marrëveshjeve të nënshkruara mes institucioneve të rendit dhe sigurisë mes dy vendeve, në veçanti për thellimin e mëtejme të këtij

bashkëpunimi.

Në fund të takimit ministri Sveçla dhe ambasadori Malaj u pajtuan për angazhim të mëtejme në avancimin e politikave në shërbim të rendit, ligjit dhe qytetarëve të vendeve tona.



## Pas betejës gjyqësore, rikthehen në punë 19 zyrtarët komunalë të Gjilanit

GJILAN, 14 NËNTOR - Janë rikthyer në vendet e tyre të punës 19 zyrtarët komunalë të Gjilanit. Gjykata e Apelit e ka vërtetuar vendimin me të cilin ishin liruar nga akuza për korrupsion me tenderë dhe krim të organizuar. Lajmin e ka bërë me dije Dega e Partisë Demokratike të Kosovës në Gjilan.

“Turpi qoftë mbi secilin që orkestroi këtë proces të montuar politikisht. Hetues dhe prokurorë, akterë politik nga LDK-ja por edhe nga eksponentë të VV-së në Gjilan, të cilët inicuan dhe inskenuan një proces gjyqësor me aktakuzat të shpifura, kundër 39 zyrtarëve më profesional në



institucionet komunale dhe afaristëve tjerë të suksesshëm të Gjilanit”, thuhet në njoftimin

për medie.

Më tutje thuhet se PDK-ja dhe ish-kryetari i komunës, Qemaj

Mustafa, ishin cak i sulmeve me akuza të pabaza për ta eliminuar politikisht përmes fyerjeve e shpifjeve që buronin nga kryetari i LDK-së dhe ish-kryetari i komunës, Lutfi Haziri, si dhe eksponentë të tjerë nga LV-ja në Gjilan.

Kryetari i Degës së PDK-së në Gjilan, Riad Rashiti, ka vlerësuar se dëmet dhe pasojat e kësaj maskarade politike dhe të sistemit gjyqësor janë të jashtëzakonshme dhe shumëdimensionale që i janë shkaktuar subjektit të tyre politik, institucioneve komunale, familjeve të zyrtarëve komunalë, afaristëve dhe imazhit të qytetit të Gjilanit.

“LDK-ja dhe LV-ja sot duhet t’i kërkojnë falje publike secilit të akuzuar për përfitime politike, secilës familje që e përjetoi dhe kaloi nëpër këtë situatë të rëndë, në veçanti t’u kërkojnë falje tri familjeve që humbën më të dashurit e tyre gjatë këtij procesi të montuar gjyqësor. Nëse nuk i vret ndërgjegjja dhe nuk ndodh kërkimfalja publike, atëherë e vetmja rrugë do të jetë demaskimi i këtij procesi dhe inicimi i procedurave ligjore për kompensim dhe llogaridhënie për secilin akter politik që ka fyer dhe akuzuar me lloj-lloj shpifje para qytetarëve të Gjilanit dhe publikut të Kosovës”, ka thënë Rashiti.

## 25 të rinj nga diaspora përforcojnë lidhjet me Kosovën përmes diplomacisë qytetare



PRISHTINË, 14 NËNTOR - Zëvendësministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Liza Gashi, në mjediset e MPJD-së ka pritur gjeneratën e dytë të programit për diplomaci qytetare, duke u uruar të rinjve mirëseardhje në vendin e tyre.

Gjatë bashkëbisedimit me anëtarët e programit për diplomaci qytetare, zëvendësministria Gashi tha se ky program, duke pasur parasysh gjeneratën e parë, ka rezultuar të jetë një mundësi e mirë që të rinjtë tanë në diasporë të rilidhen

me vendin, duke sjell përvojën dhe praktikën e tyre. Prandaj duke parë rëndësinë e këtij programi, Gashi tha se ndihet mjaft e lumtur që këtë vit numri i anëtarëve të programit është rritur në 25 veta nga 11 shtete të cilët do të angazhohen

edhe në ministrinë e tjera të linjës. Kështu, do të rritet edhe mundësia e krijimit të lidhjeve të reja me shtetet prej nga vijnë këta profesionistë. Në fund zëvendësministria Gashi, duke i falënderuar për vullnetin e reguar për angazhim në kuadër

të këtij programi, u uroi shumë suksese.

Ajo u shpreh se një program i tillë jo vetëm do t’u mundësojë angazhim të drejtpërdrejtë në institucionet e Republikës së Kosovës, por edhe do ta forcojë lidhjen e tyre me Kosovën.

## Përmbillet faza e parë e kompletimit të kabineteve shkollorë në Skenderaj

SKENDERAJ, 14 NËNTOR - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka njoftuar për përmbylljen e

fazës së parë të kompletimit të kabineteve shkollorë me pajisje të duhura për mësimin praktik për nxënësit

e drejtimit të mjekësisë në Institucionin për Arsim dhe Aftësim Profesional “Anton Çetta”. Ai ka thënë se duke

përmbushur detyrimin tonë për arsim, po krijojnë profesionistë të së nesërme në mjekësi.



# Policia dhe Dogana kapin mall të kontrabanduar rreth 18 000 euro

EPOKA  
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, në vazhden e zbatimit të masave për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, në veçanti të kontrabandës, kanë shtuar kontrollet taktike dhe operacionale në terren. Pas pranimit dhe trajtimit të informacioneve përmes rrugëve zyrtare të PK-së, është identifikuar dhe është arrestuar një person i dyshuar i cili kishte të ngarkuar një automjet me mall të kontrabanduar në Viti, i cili dyshohet se po fuste mallin e kontrabanduar përmes rrugëve ilegale nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Republikën e Kosovës. “Me datën 13.11.2023 Njësia e Task Forcës - Lindje gjatë zbatimit të detyrave sipas autorizimeve policore për parandalimin, identifikimin dhe arrestimin e personave të dyshuar

kryes të veprave penale, ka ndaluar një automjet të cilin e drejtonte i dyshuari mashkull kosovar me iniciale R. T., tek i cili gjatë kontrollimit të mjetit janë gjetur të ngarkuara 43 paketa me mallra-suplemente (proteina) të llojeve të ndryshme me peshë rreth 210 kg, me vlerë sipas tregut rreth 18 000 euro, mall për të cilin nuk kishte asnjë dokument mbi prejardhjen e tij, i cili dyshohet se ishte kontrabanduar përmes rrugëve ilegale nga RMV-RKS”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Lidhur me rastin është kryer edhe kontrolli në një lokacion tjetër të dyshuar, por nuk është gjetur sasi e mallrave të tjera. “Të gjitha veprimet rreth rastit janë ndërmarrë në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit. Me urdhër të prokurorit kompetent malli dhe automjeti janë dërguar në terminalin doganor Dheu i Bardhë dhe rasti trajtohet tutje në procedurë të rregullt”, thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës.



# Përfaqësuesit e qeverisë dhe të shoqërisë civile diskutojnë për çështjen në arsim

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, i shoqëruar nga ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka zhvilluar takimin e rregullt të radhës me organizata të shoqërisë civile. Takimi ishte i dedikuar për fushën e arsimit.

U bisedua mbi prioritetet nga Agjenda Evropiane e Reformave II në këtë fushë, si përmirësimi i cilësisë së përgjithshme në sektorin e arsimit; sigurimi i qeverisjes transparente të institucioneve arsimore; dhe rritja e qasjes në arsim.

Përfaqësuesit e qeverisë kanë theksuar se nga viti i ardhshëm do të vazhdojnë vetëm me Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024-



2028, derisa masat e mbetura nga ERA dhe rekomandimet e raportit të vendit do të përfshihen në atë plan.

Sipas përfaqësuesve të qeverisë, sa i përket shoqërisë civile, raporti i fundit për vendin vlerëson se ajo

po funksionon në një mjedis të favorshëm.

U tha se shoqëria civile vazhdon të marrë pjesë aktivisht në konsultimet publike dhe të kontribuojë në proceset e politikëbërjes dhe monitorimit.

“Platforma online për konsultime publike është përditësuar me veçori që lehtësojnë edhe pjesëmarrjen e personave me nevojë të veçanta. Raporti gjithashtu konstaton se OSHC-të, palët e interesuara dhe publiku u

angazhuan pothuajse katër herë më shpesh në konsultime publike në nivel qendror krahasuar me vitin 2021. Si qeveri, i shohim akterët e shoqërisë civile si partnerë në procesin e integritimit evropian ku secila palë ka rolin e saj dhe mund të japë kontribut si në hartim, monitorim, zbatim apo komunikim të reformave. Reformat e brendshme në sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë, progresi ekonomik dhe social, liberalizimi i vizave dhe përkushtimi në bashkëpunimin rajonal konfirmojnë se po bëjmë hapat e duhur e në rrugën e duhur drejt të ardhmes evropiane”, është bërë me dije në njoftimin e qeverisë.

Takimet e radhës për këtë vit do të jenë në fushën e sundimit të ligjit, reformës së administratës publike e për sektorin e energjisë.

# Buxheti për vitin 2024 pritet të diskutohet dhe të votohet të enjten në Kuvendin e Kosovës

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Kryesia e Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur të hënën ka caktuar seancën e re plenare për të enjten, më 16 nëntor, ku pritet të diskutohet dhe të votohet buxheti për vitin 2024. Sipas rendit të ditës, në seancën e caktuar për të enjten për diskutim dhe votim do të jetë Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024, sipas rekomandimit të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere.

Në mbledhjen e saj të 171-të, Qeveria e Kosovës miratoi Projektligjin për ndarjet

buxhetore për vitin 2024. Kryeministri Albin Kurti në fjalën e tij tha se buxheti për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro. Sipas tij, përmes buxhetit të propozuar parashihet që koeficienti i pagave në sektorin publik do të jetë 110 euro, pesë euro më shumë sesa në vitin e kaluar. “Për sektorin publik kemi thënë qysh në fillim të këtij viti se koeficienti i pagave për vitin 2024 do të jetë 110 euro dhe këtë po e realizojmë, pra po i rritim pagat në sektorin publik ashtu siç kemi thënë”, ka thënë ai në këtë mbledhje.

Buxheti për vitin 2024, sipas kryeministrit Kurti, do t'i kushtojë rëndësi të veçantë mbrojtjes e sigurisë prandaj, sipas tij, është rritur numri i policëve edhe për 500 të tjerë dhe numri i ushtarëve edhe për 600 të tjerë. Sipas Kurtit, arsimi do ta ketë mbështetjen e nevojshme, në shëndetësi do të vazhdohet në investimin e renovimit të spitaleve dhe blerjeve të pajisjeve të teknologjisë së fundit. Për drejtësinë ai ka deklaruar se buxheti për Ministrinë e Drejtësisë është rritur 31 % më shumë sesa ka qenë vitin e kaluar.



## Çitaku për buxhetin: Gjysma e parave për projektet e reja janë ndarë për komunat ku sundon LV-ja

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se shumica e investimeve kapitale për buxhetin e

planifikuar të kësaj qeverie janë për projekte të moçme të qeverive paraprake. Ndërsa, sipas saj, te projektet e reja, gjysma e parave janë ndarë për ato pak komuna ku sundon

Vetëvendosja. “Sipas raporteve kredibile, janë mu këto pak komuna ku transparenca dhe ekzekutimi i projekteve kapitale është më e ulëta. Pra paratë e taksapaguesve po

ndahen në baza partizane. Këto janë fakte. Numra. Raporte. Çdo gjë tjetër është propagandë, e vetmja fushë ku qeveria po shkëlqen”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”.



## 8.1 milionë euro tatimi shtesë nga hetimet tatimore

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës në ATK ka një rol kyç në sigurimin e barazisë mes bizneseve si dhe mbrojtjen e sistemit tatimor nga çdo individ a biznes të cilët qëllimshëm u shmangen detyrimeve tatimore. Brenda dhjetë muajve të këtij viti Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës ka arritur që nga hetimet e bëra ta rrisë tatimin shtesë për 8.1 milionë euro nga 4.6 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2022. Përderisa vlera e shmangies tatimore me ndëshkime është konstatuar 4.3 milionë euro, që thekson vigjilencën e shtuar të hetuesisë tatimore krahas vitit 2022 që ishte 3.7 milionë euro. Këto hetime zhvillohen për t'i identifikuar shkeljet e

mundshme të rregullave tatimore dhe shmangien e obligimeve financiare nga individë apo biznese. Përmes analizave të thelluara dhe monitorimit të transaksioneve, autoritetet tatimore mund të zbulojnë mosraportime të të ardhurave, transferime të paligjshme dhe keqpërdorime të tjera financiare. “Funksioni kryesor i hetimeve tatimore është të sigurojë që të gjitha subjektet tatimore kontribuojnë në mënyrë të barabartë dhe ligjore në mbajtjen e barrës tatimore. Kjo jo vetëm që siguron burime të mjaftueshme për financimin e shërbimeve publike, por gjithashtu ndihmon në parandalimin e pasigurisë fiskale dhe në ruajtjen e integritetit të sistemit tatimor”, ka njoftuar ATK-ja.



## Paralajmërohet protestë ndaj komunës së Prishtinës për mosrritjen e pagave për punëtorët teknikë



PRISHTINË, 14 NËNTOR - Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës (SPSPK), Jusuf Azemi, ka bërë me dije se janë në përgatitje të protestave ndaj komunës së Prishtinës për shkak të mosrritjes së pagave për punëtorët teknikë. Përderisa tha se pas presionit të bërë në drejtim të Qeverisë së Kosovës kanë arritur të ngrehen pagat në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë për punëtorët teknikë. Sipas tij, bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe të Shëndetësisë ka qenë në nivelin e duhur. “Tani jemi në prag të protestave në raport me komunën e Prishtinës”, ka thënë Azemi për “Ekonomia Online”. Ai ka thënë se kërkesat që i kanë pasur në raport me Qeverinë e Kosovës, gjegjësisht me Ministrinë e Shëndetësisë, për

punëtorët nëpër spitale dhe me Ministrinë e Arsimit, për punëtorët teknikë që punojnë në Universitetin “Hasan Prishtina”, janë realizuar ose janë në proces të realizimit. “Derisa te punëtorët e spitalit paga e tyre nga 235 euro tash ka shkuar në 405 euro dhe te punëtorët e Universitetit të Prishtinës, pasi kemi caktuar datën për të hyrë në grevë, kemi takuar zëvendësministrin e Arsimit dhe jemi dakorduar që kërkesat tona të realizohen. Mendojmë se koeficienti i pagës duhet të jetë 130 euro”, është shprehur Azemi. Edhe përkundër këtyre, ai u shpreh se nuk janë të kënaqur me realizimin e kërkesave nga ana e institucioneve përgjegjëse, duke shtuar se ikja e të rinjve po vazhdon.

## Posta vë në qarkullim pullën postare me imazhin e Kongresit të Manastirit

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Posta e Kosovës, përmes Filatelisë së saj, nga sot ka vë në qarkullim pullën postare me imazhin që shënon 115-vjetorin e Kongresit të Manastirit, vendimet e të cilit konsiderohen si zanafilla e letërsisë shqiptare përmes

krijimit të alfabetit të unifikuar shqiptar. Kongresi i Manastirit ishte një prej ngjarjeve më të rëndësishme kulturore, arsimore dhe kombëtare që e karakterizonte Lëvizjen e Rilindjes Kombëtare Shqiptare

në fillim të shekullit XX, në të cilin u përpilua dhe u njëhua për herë të parë alfabeti i gjuhës shqipe. Ky Kongres historik ishte organizuar në kushte dhe rrethana të rënda kombëtare dhe ndërkombëtare. Me

praninë e 150 delegatëve, të ardhur nga të gjitha trevat e Shqipërisë etnike, me përfaqësim edhe nga shoqëritë shqiptare jashtë atdheut, u vendos që alfabeti i gjuhës shqipe të ketë bazë shkronjat e alfabetit latin.





# Çfarë i shtyu francezët, për ta përmbysur monarkinë?

Historiani Robert Darnton gërmon thellë në Francën e shekullit XVIII, për të gjetur rrënjët e trazirave politike që kulmuan në vitin 1789,



"Pema e Krakovit" në kopshtin e Pallatit Mbretëror, ku njerëzit mblidheshin për të dhënë lajmet dhe thashethemet (Archives Charmet/Bridgeman Images)

Nga: Tony BARBER /  
*The Financial Times*  
Përkthimi: Telegrafi.com

Një kryevepër e lënë pas dore e letërsisë franceze e regjimit të vjetër është Tabloja e Parisit [Tableau de Paris] e Louis-Sébastien Mercierit, një vëzhgim i detajuar i jetës së përditshme në prag të revolucionit të vitit 1789. "Të gjithë duan të jenë autorë apo lexues. Edhe karrocieri lexon veprën e fundit në parmakun e vet. Çdo person, deri te shërbëtorët e shtëpisë dhe bartësit e ujit, është i përfshirë në debat", shkroi Mercier. Etja e parisianëve për lajme politike, në vitet 1780, mund t'i atribuohet përhapjes së perceptimit se monarkia është gati për të falimentuar dhe se asaj po i mbaronin opsionet – pasi skandalet gjyqësore u ndezën, çmimet e bukës u rritën dhe kritikët kërkuar reforma.

Megjithatë, siç ilustron Robert Darntoni në *Temperamentin revolucionar* [The Revolutionary Temper], interesimi për çështjet

publike ishte i dukshëm edhe 40 vjet më parë, në kohën kur ishte e çuditshme të parashikoje revolucionin që do të riorganizonte qeverinë dhe shoqërinë franceze nga lart-poshtë.

Si historian i shquar amerikan i Francës së shekullit XVIII, Darntoni e kishte detyrë jetësore që të gërmojë nën sipërfaqen e ngjarjeve të njohura politike dhe të tendencave intelektuale të asaj kohe, dhe të portretizojë jetën e francezëve nga këndvështrimet e pazakonta dhe stimuluese. Darntoni – autori i veprave klasike si *Masakrimi i madh e maceve* dhe *Bestsellerët e ndaluar të Francës para-revolucionare* – ka përdorur ditarët, letrat, gazetat, pamfletet dhe lajmet informale, si dhe proceset gjyqësore dhe traktate iluministe për të prodhuar një tjetër libër të qartë, të argumentuar dhe argëtues.

Në dekadat deri te rënia e Bastiljes në korrik 1789, një lloj i ri i letërsisë protestuese i theksoi të drejtat e qytetarëve, rrezikun e despotizmit dhe autoritetin e kombit francez,

shkruan Darntoni. Por, shpeshherë, rrugën deri te parisienët këto ide radikale e gjetën përmes kanaleve indirekte. Vështirë se mund të ishte ndryshe kur kostoja e Enciklopedisë [Encyclopédie], e atij monumenti të arsyes moderne, ishte e barabartë me pagën jetësore të një punëtori.

Në vend të kësaj, revistat më të lira periodike botuan fragmentet që gojarisht arritën te publiku. Me interes të veçantë është *Pema e Krakovit* – një pemë e madhe e gështenjës në kopshtin e Pallatit Mbretëror [Palais-Royal] në qendër të Parisit – ku shitësit e lajmeve gojore takoheshin për të transmetuar raportet politike dhe thashethemet. Kishte gjithashtu këngë dhe poezi të çuditshme, si vargu anonim për zonjën de Pompadour – dashnore e Luigjit XV: *Louis le mal-aimé/ Fais ton jubilé/ Quitte ta putain/ Et donne-nous du pain* (Luixh i padashur/ mbaroje jubileun tënd/ lëre kurvën/ bukë na jep).

Volteri, fshikulluesi i hipokrizisë dhe padrejtësisë, në vëmendjen e

publikut solli një prej skandaleve më të mëdha të shekullit, kur shkroi për ekzekutimin e tmerrshëm të vitit 1762 të Jean Calasit, të tregtarit të moshuar protestant të akuzuar në mënyrë të rreme për vrasjen e djalit të vet, sepse ky i fundit donte të konvertohej në katolicizëm. Jean-Jacques Rousseau në një mënyrë tjetër e ktheu opinionin kundër rendit të vendosur: përmes historisë së tij të dashurisë të vitit 1761, *Zhuljeta ose Eloiza e re* [La Nouvelle Héloïse] – bestselleri më i madh francez i shekullit XVIII. "Kurrë nuk derdha lot kaq të shijshëm", i shkroi një lexues filozofit Rousseau.

Në vitet 1780, lajmet jopolitike mbërthyen parisianët po aq sa politika. Gazetat periodike trumbetuan zbulimet e supozuara shkencore, të tillat si shpikja e nëndetësve dhe e robotëve që luajnë shah. Turmat e mëdha shikuan fluturimet e para duke përdorur balonat me ajër të nxehtë ose lexuan rreth tyre nëpër fletushkat e lajmeve.

Megjithatë, në fund ishte një lidhje

me politikën. "Bota natyrore ishte e gatshme të dominohej nga ata që mund të deshifronin ligjet e saj të brendshme. Mbase mund të zotërohen edhe ligjet që qeverisin shoqërinë", ka shkruar Darntoni. Deri në vitin 1789, shumë francezë – veçanërisht të ashtuquajturat Klasa e Tretë, ose njerëzit që nuk ishin fisnikë apo klerikë – e mendonin veten si qytetarë aktivë të aftë për të imponuar ndryshimin. Siç shkruante Abbé Sieyès në një traktat prej 127 faqeve që kushtonte vetëm 30 susë dhe që edhe sot shtypet: "Çfarë është Klasa e Tretë? Gjithçka. Çfarë ka qenë deri tash në rendin politik? Asgjë. Çfarë kërkon? Për t'u bërë diçka brenda tij".

Hapësira e lajmeve të Parisit ishte mbushur me tema të tilla, duke lënë pak hapësirë për pikëpamjet pro-qeveritare. Libri i Darntonit është tregim shumë i mirë për atë se si parisianët e shekullit XVIII i pranuan dhe i interpretuan ngjarjet publike, duke i vënë ato në rrugën e revolucionit. /Telegrafi/

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## Sonte Peja dhe Trepça zhvillojnë ndeshjet në FIBA Europe Cup

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Të mërkurën Peja dhe Trepça do të kenë sfida të rëndësishme në grupet e FIBA Europe Cup. Kampionët e Kosovës do të jenë mysafirë të Heroes Den Bosch në një sfidë jetike. Verdhezinjtë kanë dy fitore e dy humbje,

duke u renditur në vendin e dytë, kurse holandezët kanë katër humbje në katër ndeshje. Pejanët kishin triumfuar ndaj holandezëve 99:84. Liderët e Superligës kanë mundur edhe PGE Spojnia Stargard që ka, po ashtu, dy fitore e dy humbje.

Polakët do të ndeshen me Niners, që ka katër fitore në katër ndeshje dhe ka siguruar kualifikimin tutje. Ndërkohë, Trepça është mysafirë e ZZ Leiden. Holandezët dhe BCM Gravelines Dunkerque kanë dy fitore e një humbje,

ndërsa mitrovicasit kanë pësuar dy humbje në dy ndeshje. Fituesit e Kupës dhe Superkupës së Kosovës ishin mundur nga ZZ Leiden në Mitrovicë me shifrat 54:84. Të dyja ndeshjet zhvillohen nga ora 20:00.



## Berisha: Në Moldavi shkojmë për fitore

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha në konferencë për medie të martën ka thënë se u transferua në skuadrën e Empolit vetëm e vetëm për të ruajtur formën e mirë dhe kjo tash po shpaguhet.

“Ne jemi në një moment shumë delikat, jemi shumë të fokusuar në këto ndeshje. Forma ime ka qenë një nga arsyet pse kam shkuar te Empoli sepse doja të isha i gatshëm dhe në formë shumë të mirë dhe kjo po ndodh për fat të mirë, ndërsa pjesa tjetër i takon trajnerit”, ka thënë Berisha. Portieri nga Kosova ka shkëlqyer në ndeshjen e fundjavës kundër Napolit, derisa në konferencë është pyetur se a mund ta bëjë të njëjtën gjë edhe kundër Moldavisë, Berisha është përgjigjur: “Atë ndeshje e kam harruar tani dhe jam i fokusuar te



ndeshjet që kemi me Moldavinë. Jemi entuziastë, por duhet të jemi me këmbë në tokë. Me gjithë respektin që kemi për ta, duhet të

shkojmë atje për fitore”. “Jo nuk kemi eufori, por entuziazëm dhe duhet të vazhdojmë kështu, pasi është e vështirë të kesh

entuziazëm. Na ka ndodhur më herët të ishim në vështirësi dhe kemi derdhur shumë djersë që të arrijmë këtu. Duhet t'i bëjmë gjërat

siç duhet dhe nëse do të kemi mundësi të kualifikohemi në Evropian, duhet të bëjmë gjëra më të mira seç kemi bërë deri tani”, ka deklaruar portieri kuqezi. Berisha në fund ka thënë se kuqezinjtë do të bëjnë maksimumin si ndaj Moldavisë ashtu edhe ndaj Ishujve Faroe dhe do të luajnë për fitore. “Mundohem ta kuptoj situatën e Moldavisë, të kesh përballë një skuadër siç jemi ne është e vështirë. Çdo ekip me të cilin jemi përballur e kemi vënë në vështirësi, do të bëjmë të njëjtën gjë me Moldavinë. Megjithatë ata nuk kanë asgjë për të humbur dhe ndonëse favorit në letër jemi ne, duhet të bëjmë maksimumin. Të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe ndaj Ishujve Faroe edhe ndaj tyre duhet të luajmë për fitore”, ka përfunduar Berisha.

## Hysaj: Janë dy finale të mëdha për ne



TRANË, 14 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll do të zhvillojë brenda shtatë ditësh dy sfidat

“finale”, siç i quan edhe tekniku Sylvinho, të fazës kualifikuese të Kampionatit Evropian “Euro 2024”,

ndaj Moldavisë, më 17 nëntor, në Çisinau dhe ndaj Ishujve Faroe, me datë 20 nëntor, në mitikun “Air Albania”, ku vetëm 1 pikë, nga këto 2 sfida, mjafton që kuqezinjtë të prejnë një biletë drejt Gjermanisë, aty ku do të zhvillohet faza finale e kompeticionit. Nga konferenca për shtyp disa fjalë për këto dy përballje i ka thënë edhe anëtori i mbrojtjes së Kombëtares, Elseid Hysaj, i cili ka deklaruar se skuadra vlerëson maksimalisht kundërshtarët dhe do ta kërkojë maksimumin në të dy ndeshjet, për t'u dhënë vazhdimësi rezultateve pozitive. “Janë dy finale shumë të mëdha për ne, por duhet të mendojmë për Moldavinë, pasi është një ndeshje shumë e rëndësishme dhe kundërshtari po

kalon një formë shumë të mirë. Ne e dimë mirë që do të shkojmë atje për të mos humbur, pasi edhe një pikë na nevojitet për t'u kualifikuar, por do të ishte edhe më bukur po të fitonim dhe ta arrinim rekordin e pikëve”, ka thënë Hysaj, i cili më pas është pyetur se a ngjan kjo ndeshje me atë ndaj Armenisë në 2015-n. “Kanë lidhje, por si ndeshje duket më e thjeshtë, pasi na duhet vetëm një pikë në dy takime. Është një ndeshje me peshë pasi, nëse fitojmë, do të kthehemi të kualifikuar dhe të bëjmë festë. Nëse humbim, do të na shtohet shumë presioni. Jemi të përgatitur për të shkuar dhe fituar, pasi duam të kthehemi të gëzuar dhe të festojmë me tifozët”.

Hysaj është një nga futbollistët kuqezi që e ka përjetuar kualifikimin në Evropianin e vitit 2016. “Është një ndjesi e bukur, që nuk mund ta harrosh dhe shpresoj ta shijojnë edhe çunat e tjerë, por ta përsërisim unë e Berisha apo ndonjë tjetër”, ka shtuar Hysaj. Më pas mbrojtësi që aktivizohet te Lazio i ka bërë edhe një vlerësim Kombëtares së Moldavisë. “Është një skuadër që nuk ka pësuar asnjë humbje në shtëpi. Rri mbrapa dhe del shpejt në kundërsulm për golin. Ne e kemi përgatitur kështu, që t'i shfrytëzojmë mundësitë tona dhe të gjejmë golin”, ka deklaruar Hysaj, i cili ka këmbëngulur se këtyre kualifikuesve do t'u japë notë vetëm pasi të këtë përfunduar edicioni eliminator.

## Kosova U19 pëson humbje nga Sllovenia në ndeshjen përcaktuese

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës U19 ka pësuar humbje nga Sllovenia U19 në ndeshjen vendimtare për promovim në Ligën A për kualifikimet e Evropianit “Lituania 2024”. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin “Igrišče Terme” në Çatezh u mbyll me shifrat 5-

2 në dobi të vashave sllovene. Rezultati u zhblllokua në minutën 9 kur shënoi Naja Miheliç. Vetëm dy minuta më vonë Noelle Vilčnik shtoi epërsinë e slloveneve në 2-0, teksa Naja Miheliç shënoi pak para përfundimit të pjesës së parë për 3-0. E njëjta futbolliste kompletoi tre gola

vetëm dy minuta pasi filloi pjesa e dytë për 4-0. Të përzgjedhurat e Albina Rrahmanit në minutën e 51-të e ngushtuan disavantazhin me golin e Eltina Bozhdaraj. E njëjta futbolliste realizoi edhe në minutën e 80, por ishte vonë për ndryshim të epilogut të ndeshjes, ngaqë

paraprakisht në minutën e 61-të Sllovenia shënoi edhe golin e pestë përmes Nezha Çebashek. Duhet theksuar se për “dardanet” gjërat u vështirësuan edhe më shumë në minutën 60 kur Kreshnike Ramaj u përjashtua nga loja pas kartonit të dytë të verdhë.



## Guardiola: Të gjithë e kanë të vështirë ndaj Chelseat

MANCHESTER, 14 NËNTOR - Chelsea dhe Manchester City kanë zhvilluar ndeshjen më të mirë këtë edicion dhe jo vetëm në Ligën Premierë. Të dielën dy gjigantët anglezë u përballen në "Stamford Bridges" dhe në fund barazuan pas tetë golave të

shënuar 4-4. Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka thënë se Chelsea është një skuadër e fortë dhe është përballur me shumë skuadra të mëdha në mënyrë fantastike. "Chelsea është një skuadër shumë e mirë, kështu që nuk ka

dysim. Liverpooli nuk mundi të fitonte në 'Stamford Bridge'. Ata ishin shumë, shumë më të mirë se Arsenali dhe në fund, 'topçinjtë' barazuan. Pra, e dini, është Chelsea. Ajo nuk do të largohet kurrë nga radha e skuadrave të mëdha. Unë gjithmonë duhet të mendoj se

çfarë mund të bëjmë për t'u përmirësuar. Nuk do të ndodhë që ne të vijmë këtu dhe të fitojmë 7-0", ka thënë Guardiola. "Chelsea po përpiqet të rindërtohet dhe nuk kemi ankesa për këtë barazim", ka deklaruar Guardiola.



## Matthaus: Kane do ta thyejë rekordin e Lewandowskit

MUNCHEN, 14 NËNTOR - Harry Kane e ka nisur për mrekulli aventurën e tij te Bayern Munich, duke shënuar gola shumë të rëndësishëm. Sulmuesi anglez në 11 ndeshje në Bundesliga ka realizuar 17 gola dhe ka asistuar në pesë të tjerë duke prirë në listën e top shënuesve në elitën e futbollit gjerman. Megjithatë anglezi do ta ketë para vetes një objektiv për ta thyer rekordin e polakut Robert Lewandowski. Reprerentuesi polak në sezonin 2020/21 ishte i jashtëzakonshëm duke realizuar 41 gola në Bundesliga dhe shtoi shtatë asistime.

Legjenda e Bayernit, Lothar Matthaus, është i bindur se Kane do ta thyejë rekordin e Lewandowskit kur kanë mbetur edhe 25 ndeshje deri në fund. "Pas ruajtjes së trendit pozitiv ndaj ekipeve jo të lehta në mbrojtje si Dortmund dhe Heidenheim, jam i bindur se Kane do ta thyejë rekordin e Robert Lewandowskit.



Ruga është e gjatë, vetëm ndonjë dëmtim i rëndë do ta bënte të pamundur, por s'besoj, marrë në konsideratë rezistencën e anglezit", ka thënë Matthaus. "Ai ka luajtur në Ligën Premierë, kampionati më dinamik dhe ia ka dalë, ndërsa Gjermania disi më e

butë në ndërhyrje. Interpretimi i pykës së kampionëve në ligë vërtet speciale. Mjeshtëria në ndaljen e topit, ekzekutimi i goditjeve, qetësia dhe mbështetja që u fal shokëve të ekipit, e ka ngritur kaq lart grupin e Tuchelit", ka deklaruar Matthaus.

## Bostoni i bashkohet Philadelphias në krye

BOSTON, 14 NËNTOR - Pas dhjetë ndeshjeve të para sezonale të NBA-s kanë nisur të konfigurohen skuadrat realisht pretendente si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Në Lindje, Bostoni i bashkohet Philadelphias në krye të renditjes pas fitores me rezultat 114-98 ndaj New Yorkut. Kjo ishte fitorja e tetë sezonale për Celticsin, e treta radhazi, ku u dallua Jayson Tatum me 35 pikë. Brunson e Randle realizuan 51 pikë për një-jorkezët, por që mbetën për statistikë. Një sfidë e dominuar nga vendasit vetëm në gjysmën e dytë të lojës. Rikthehet te fitorja ekipi i Milwaukee, që mposhti me rezultat 118-109 Chicagon, një sfidë e komanduar nga



skuadra e Bucksit. Ndeshje e mirë për Giannis Antetokounmpo, autor i 35 pikëve e 11 reboundeve, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e 12 reboundet e Vuçeviqit për Bulls. Po në Lindje fitore të rëndësishme arriti edhe skuadra kanadeze e Torontos, që mundi me rezultat 111-107 Washingtonin. Siakam me 39 pikë e 11 rebounde ishte

vendimtar për Raptorsin, që tashmë balancohen me 5 fitore dhe 5 humbje. Vetëm një ndeshje u luajt në Perëndim. Skuadra e Sacramentos, falë një kuarteti lojtarësh që realizuan mbi 20 pikë, ku Fox me 28 pikë ishte më i miri, mundi 132-120 Clevelandin. Fitorja e tretë radhazi për Kingsin, që ngjitet në vendin e gjashtë.

### REZULTATET

Boston - New York	114-98
Toronto - Washington	111-107
Milwaukee - Chicago	118-109
Sacramento - Cleveland	132-120

## Kroacia pa Kovaqiqin ndaj Letonisë dhe Armenisë

Kroacia po përgatitet për ndeshjet kualifikuese të "Euro 2024" ndaj Letonisë në transfertë (18 nëntor) dhe Armenisë në shtëpi (21

nëntor). Mesfushori i njohur Mateo Kovaqiq nuk do jetë i gatshëm për këto sfida. Shkak është bërë një lëndim dhe është parë e arsyeshme të

mos jetë në listë. "Mateo Kovaqiq, i cili iu nënshtua testeve mjekësore në Manchester, është përjashtuar për ndeshjet e

ardhshme për shkak të një lëndimi muskolor, i cili tregoi se ai nuk do të jetë i gatshëm për ta ndihmuar kombëtaren në ndeshjet e ardhshme për

shkak të lëndimit", ka njoftuar Federata Kroate e Futbollit. Kovaqiq numëron 97 ndeshje për Kroacinë dhe ka shënuar 5 gola.

### SHKURT

#### Eshref Beqiri, delegat i EHF-së në dy ndeshje evropiane

Delegati i EHF-së nga Kosova, Eshref Beqiri, në fundjavë ishte i angazhuar në dy ndeshje evropiane. Anëtari i FFK-së, Beqiri, ishte i deleguar nga Federata Evropiane e Hendbollit për t'u kujdesur për mbarëvajtjen e ndeshjeve në mes të Mlinotest Ajdovshçina (Slloveni) dhe Herzogenbuchsee (Zvicër). Këto ndeshje i kanë takuar raundit të tretë të Kupës Evropiane për Hendbolliste, ndërsa janë zhvilluar në Ajdovshçina të Sllovenisë të shtunën e të dielën. Ndeshjen e parë e fitoi skuadra sllovene me rezultat 35:24. Mlinotesti e fitoi 21:20 ndeshjen e dytë dhe kështu avancoi tutje. Beqiri për gjyqtarë e kishte dyshen nga Italia, Stefano Riello-Niccolo Panetta. Ai po delegohet gjithnjë e më shpesh në ndeshje të grave evropiane.

#### Pësoi sulm në zemër në fushë, Bas Dost heq dorë nga futbolli

Sulmuesi i njohur holandez Bas Dost pësoi një sulm në zemër në ndeshjen e fundit me NEC kundër AZ Alkmaar dy javë më parë. Ndërhyrja e shpejtë e stafit mjekësor në fushë i shpëtoi jetën futbollistit, më pas ai u dërgua në spital për kujdes të mëtejshëm. Tashmë pasi ka kaluar periudhën e vështirë, Bas Dost ka lënë spitalin në Amsterdam, megjithatë si masë paraprake i është vendosur një defibrilator i brendshëm. Pas diagnostikimit të miokardit, sulmuesi ka njoftuar se nuk do të zbrisë më në fushën e blertë. "Jam i lumtur që jam kthyer në shtëpi dhe do të shërohem tani. Dua t'i falënderoj të gjithë ata që më kanë mbështetur gjatë kësaj periudhe", ka thënë Bas Dost.

#### Sacchi: Interi dhe Juventus do të luftojnë për 'Scudetto'

Ish-trajneri legjendar i Milanit, Arrigo Sacchi, pret që gara për titull në Serinë A të vendoset mes Interit dhe Juventusit. Sacchi në një intervistë për "Gazzetta dello Sport" ka deklaruar se fakti që Juventus nuk luan futboll evropian mund të rezultojë një avantazh për "Bianconerët". "Është ende herët të thuhet se gara e 'Scudetto' është një duel mes Interit dhe Juventusit, por ka disa të dhëna që tregojnë në këtë drejtim. Ndeshjet vendimtare priren të jenë në mars dhe prill, atëherë mund të fillojnë të marrin energji. Por 'nerazzurrit' dhe 'bianconerët' deri më tani kanë demonstruar qëndrueshmëri që i vendos ata përpara skuadrave të tjera", ka thënë Sacchi. Mementalisht lider në tabelë është Interi me 31 pikë të grumbulluara dhe menjëherë pas tyre renditet Juventusit që ka 29 sosh.

#### Shiriti i kapitenit, 'mollë' sherri mes Nagelsmannit dhe Kimmichit

Julian Nagelsmann kohë më parë është emëruar trajner i Kombëtares së Gjermanisë derisa pritej që trajneri të kishte raporte fantastike me mesfushorin Joshua Kimmich, por ka ndodhur e kundërta. Prestigjiozja gjermane "Bild" raporton se Nagelsmanni është përplasur me Kimmichin, pasi e ka graduar kapiten Ilkay Gundoganin. Edhe ky i fundit ka përfituar nga mungesa e Manuel Neuerit dhe Thmoas Mullerit.

## NJOFTIM MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "SA Financial Holding " LLC

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuar dhe ndryshuara, Aksionari i shoqërisë "SA Financial Holding " L.L.C., shoqëri me përgjegjësitë kufizuara, me numër unik identifikues 811915761 ("Shoqëria") ka nxjerr:

**VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË** me datë 06/11/2023

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet në vlerën prej 200,000.00 përkatësisht nga vlera e regjistruar **1,630,000.00 Euro** në **1,430,000.00Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

"SA Financial Holding " L.L.C., Rr. Bekim Fehmiu, objekti Arting, Kati 1, 10000 Prishtinë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/ANGARE/DOREZUAR: 16.11.2023			
DITË/PUBLIKIM/COSTAVLJEN: 16.11.2023			
DATE/ANGARE/DOREZUAR: 16.11.2023			
Nisja Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
07/2	112	2102	1



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

### NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 19.10.2023, për vendin e punës:

**I. Pozita:** Udhëheqës i Njesisë së Prokurimit

**Numri i referencës:** UNP/ZKA/15-10/23

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 2097 të datës 13.11.2023

Prishtinë, 14.11.2023

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

*D. Shkullpaj*

### OBAVEŠTENJE O PONIŠTENJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije objavljuje poništenje konkursa raspisanog u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 19.10.2023. godine, za radno mesto:

**I. Pozicija:** Rukovodioc Jedinice za nabavku

**Referentni broj:** UNP/ZKA/15-10/23

Konkurs se poništava na osnovu Odluke br. 2097 od 13.11.2023.

Priština, 14.11.2023.

Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima

*D. Shkullpaj*



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ylberie Kozmaqi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe Diplomën e shkollës së mesme Teknike "Hasan Tasini" Obiliq.

- Dinë Pajaziti nga Gjakva shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Dy Dëshmorët".

- Faton Salihu nga Gjakva shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Fidan Gjoshi nga Gjakva shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Endrit Beqiri nga Gjakva shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Eldin Etemi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Ideal Pulaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Edison Sadiku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Abdyl Frasheri" Prizren.

- Hasaf Aliqko shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Mati Logoreci" Prizren.

- Shpetim Sadiku shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10-11 të shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Sefedin Xhoshja shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Murtez Murtezi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani"-ish shkolla "Boris Kidric".

- Safet Ahmeti shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani" ish shkolla e "Boris Kidric".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

